

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I EDUKIMIT
PROGRAMI: MËSIMDHËNIE E TEKNOLOGJI ME
TIK
STUDIME POST-DIPLOMIKE MASTER**



TEZË MASTERI

TITULLI I TEMËS:

**MOTIVIMI I NXËNËSVE NGA MËSIMDHËNËSIT PËR
ORIENTIM NË KARRIERË NË SH.F.M.U**

Mentori:
Dr.sc. Sylejman Berisha

Kandidati:
Lumnije Hasani

Prishtinë, 2021

FAKULTETI I EDUKIMIT

Studimet Master

PROGRAMI: MËSIMDHËNIA E TEKNOLOGJI ME TIK

TEZA MASTER

E paraqitur nga:

Lumnije HASANI

Me kërkim të gradës shkencore

Master

Mentori: Dr.sc. **Sylejman Berisha**, Prof. i Asoc.

Tema: MOTIVIMI I NXËNËSVE NGA MËSIMDHËNËSIT PËR ORIENTIM NË
KARRIERË NË SHFMU

Mbrohet para komisionit vlerësueses të përbërë nga:

Dr.sc. Sylejman Berisha, Prof. asist. _____ mentor

Prof.Ass.Dr. Arlinda Beka _____ kryetar

Prof.Ass.Dr. Minevere Rashiti _____ anëtar

Prishtinë, 2021

PERMBAJTJA

ABSTRAKTI.....	5
ABSTRACT.....	6
LISTA E TABELAVE.....	7
LISTA E FIGURAVE.....	8
LISTA E SHKURTESAVE.....	9
KAPITULLI I.....	10
HYRJE.....	10
1.1 Rëndësia e orientimi për karrierë	11
1.2 Qëllimi i motivimit dhe orientimit për karrierë.....	12
1.3 Procesi i orientimit për karrierë.....	13
1.4 Teoria e Donald Super-it mbi hapësirën jetësore të zhvillimit të karrierës	16
KAPITULLI II.....	18
SHQYRTIMI I LITERATURËS	18
2.1 Motivimi dhe vendimarrja për orientim në karrierë	20
2.2 Faktorët motivues të jashtëm dhe të brendshëm	21
2.3 Motivimi, faktorët motivues dhe performanca në punë.....	24
2.3.1 Paga, përfitimet në punë dhe performance	24
2.3.2 Kushtet e punës dhe performanca në punë	25
2.3.3 Orientimi drejt suksesit dhe performanca në punë.....	25
2.3.4 Bashkëpunimi me kolegët dhe performanca në punë.....	26
KAPITULLI III	27
METODOLOGJIA E HULUMTIMIT.....	27
3.1 Definimi i problemit.....	28
3.2 Pyetja e hulumtimit.....	29
3.3 Mostrat e hulumtimit dhe popullacioni	30
3.4 Metodatat dhe teknikat e hulumtimit.....	30
3.5 Instrumentet hulumtuese (pyetësorët)	30
KAPITULLI IV.....	29
ANALIZA E TE DHENAVE DHE REZULTATEVE	29
4.1 Rezultatet e pyetësorit të realizuar me nxenes	29
4.2 Rezultatet e pyetësorit të realizuar me nxenes	43
KAPITULLI V	49
DISKUTIMI	49
PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....	53

REFERENCA DHEBIBLIOGRAFIA	55
SHTOJCA.....	56
PYETËSORI I.....	56
PYETJE DEMOGRAFIKE	58
PYETËSOR II.....	59

ABSTRAKTI

Studimi ka për qëllim të analizojë rëndësin e motivimit të nxënësve nga mësimdhënësit dhe njohurit për orientimin në karrierë. Nëpërmjet këtij punimi kemi synuar të tregojmë rëndësin e mësimdhënësit për t'i motivuar-nxitur nxënësit, që të jenë sa më aktiv në vendimarrjen e drejtimit të tyre.

Në këtë hulumtim janë përdorur metodat për mbledhjen e të dhënave cilësore dhe sasiore, përmes pyetësorëve që janë realizuar dhe plotësuar me nxënësit e klasave të IX-ta të Shkollës Filllore "Dr. Ibrahim Rugova" në komunën e Podujevës, ku janë mbledhur të dhëna të mjaftueshme për të nxjerrur rezultatet për temën e hulumtimit.

Pyetjet hulumtuese janë;

- Sa ndikon mësimdhënësi tek nxënësit në motivim dhe orientim në karrierë?
- Çfarë rëndësie ka mësimdhënësi tek nxënësit për motivim dhe këshillim në karrierë?

Fokus kryesor janë nxënësit e klasëve të IX-ta. Pjesëmarrës në këtë hulumtim janë gjithësej 100 nxënës. Si instrument matës është përdorur para pyetësit, një ligjerat-modul me përmbajtje këshilluese për orientimin e nxënësve në karrierë dhe më pas kemi mbajtur paspyetësin.

Me anë të pyetësit të parë ne konstatojmë se sa kanë njohuri nxënësit për orientim në karrierë dhe për qendrat këshilluese.

Përmes modulit që kam mbajtur dhe paspyetësit, konstatojmë ndikimin e ligjeratës së mbajtur në rëndësin e motivimit të nxënësve për orientim në karrierë dhe informimit të tyre për qendrat këshilluese.

Për këtë hulumtim si hipotezë kemi përzgjedhur;

Hipoteza: Nxënësit që marrin informatat të mjaftueshme nga mësimdhënësit për orientim në karrierë pritet të jenë më të suksesshëm në përzgjedhjen e përshtatshme të profesioneve.

Rezultatet e studimit tregojnë se, pjesa më e madhe e nxënësve janë të vetëdijshëm me rëndësin e motivimit nga mësimdhënësit për orientim në karrierë, në informimin dhe zgjedhjen e drejtimit për ta studjuar apo ushtruar në të ardhmën. Rezultatet po ashtu tregojnë se nxënësit shumë pak janë të informuar për profesionet e ardhshme, për tregun e punës dhe për mundësitë e gjithëpërfshirjes në jetën shoqërore.

Fjalët kyçe: Orientimi në karrierë, motivimi, vendimarrje dhe mësimdhënie.

ABSTRACT

The study aims to analyze the importance of motivation of students by teachers and knowledge for career guidance. Through this paper we aimed to show the importance of the teacher to motivate and encourage students to be as active as possible in decision-making of their direction.

In this research, methods were used for the collection of qualitative and quantitative data, through questionnaires that are realized and supplemented with the students of the IX-th grades of the Primary School "Dr. Ibrahim Rugova" in the municipality of Podujeva, where sufficient data were collected to produce results for the research topic.

The research questions are:

- How much does the teacher influence students in motivation and career guidance?
- How important is the teacher to students for career motivation and counseling?

The main focus is on IX grade students. A total of 100 students are participating in this research. As a measuring instrument was used before the questionnaire, a lecture-module with advisory content for students' career guidance and then we kept the questionnaire.

Through the first questionnaire we find out how much students know about career guidance and counseling centers.

Through the module I held and the questionnaire, we ascertain the impact of the lecture held on the importance of motivating students for career guidance and informing them about counseling centers.

For this research as a hypothesis we have selected;

Hypothesis: Students receive sufficient information from teachers for career guidance is expected to be more successful in the selection of suitable occupations.

The results of the study show that most students are aware of the importance of motivation by teachers for career guidance, information and choice of direction to study or practice in the future. The results also show that students are very little informed about future professions, the labor market and opportunities for inclusion in social life.

Keywords: Career orientation, motivation, decision making and teaching.

LISTA E TABELAVE

Table 1	Analizat demografike, Gjinia.....	31
Table 2	Analizat demografike, Moshë.....	32
Table 3	Analizat demografike, Suksesi në periudhën e parë.....	33
Table 4	Analizat demografike, Vendbanimi.....	34
Table 5	Sa mund të ju motivojë mësimdhënësi në zgjedhjen e drejtimit për të studiuar?.....	35
Table 6	A posedon shkolla juaj Qendër për këshillim dhe orientim në karrierë?.....	36
Table 7	Fusha lëndore Jeta dhe Puna luajnë një rol primar për edukim dhe këshillim për karrierën tek nxënësit?	37
Table 8	Sa ndikon mësimdhënësi tek nxënësit në motivim dhe orientim në karrierë?.....	38
Table 9	Edukimi për orientim në karrierë ndihmon nxënësit për të vlerësuar arritjet, interesimet dhe prirjet e tyre?	39
Table 10	Nxënësit që marrin informatat të mjaftueshme nga mësimdhënësit për orientim në karrierë, janë më të suksesshëm në përzgjedhjen e profesioneve?	40
Table 11	Çfarë rëndësie ka mësimdhënësi tek nxënësit për motivim dhe këshillim në karrierë?	41
Table 12	Zgjedhja e profesionit të drejtë më ndihmon që të jem i/e suksesshëm në punën që do ta ushtrojë në të ardhmen?	42
Table 13	Mësimdhënësi më motivon dhe lehtëson në zgjedhjen e drejtimit për të studiuar?	43
Table 14	Sa më ndihmon qendra për orientim në karrierë në zgjedhjen e profesionit?	44
Table 15	Sa ju ka ndihmuar moduli në zgjedhjen e drejtimit për ta studiuar apo profesionit për ta ushtuar në të ardhmen?	45
Table 16	Sa keni arritur të njihni përparësitë dhe aftësitë tuaja për orientim në karrierë me ndihmën e mësimdhënësit?	46
Table 17	Orientimi dhe këshillimi për karrierë shërben si një urë lidhëse ndërmjet shkollës dhe botës së punës?.....	47
Table 18	A mendoni që nxënësit që marrin informatat të mjaftueshme nga mësimdhënësit për orientim në karrierë, janë më të suksesshëm në përzgjedhjen e profesioneve?.....	48
Table 19	Mësimdhënësi me njohuritë dhe përvojën e tij në orientim në karrierë më këshillon drejtë në zgjedhjen e profesionit?	49
Table 20	Zgjedhja e gabuar e profesionit më dërgon drejtë zhgënjimit dhe stresit në të ardhmen?.....	50
Table 20	Zgjedhja e gabuar e profesionit më dërgon drejtë zhgënjimit dhe stresit në të ardhmen?.....	50

LISTA E FIGURAVE

Figure 1 Gjinia	32
Figure 2 Mosha.	33
Figure 3 Suksesi në periudhën e pare	34
Figure 4. Vendbanimi.	35
Figure 5. Sa mund të ju motivojë mësimdhënësi në zgjedhjen e drejtimit për të studiuar.	36
Figure 6. A posedon shkolla juaj Qendër për këshillim dhe orientim në karrierë.	37
Figure 7. Fusha lëndore Jeta dhe Puna luajnë një rol primar për edukim dhe këshillim për karrierën tek nxënësit.....	38
Figure 8. Sa ndikon mësimdhënësi tek nxënësit në motivim dhe orientim në karrierë.	39
Figure 9. Edukimi për orientim në karrierë ndihmon nxënësit për të vlerësuar arritjet, interesimet dhe prirjet e tyre.	40
Figure 10. Nxënësit që marrin informatat të mjaftueshme nga mësimdhënësit për orientim në karrierë, janë më të suksesshëm në përzgjedhjen e profesioneve.	41
Figure 11. Çfarë rëndësie ka mësimdhënësi tek nxënësit për motivim dhe këshillim në karrierë.	42
Figure 12. Zgjedhja e profesionit të drejtë më ndihmon që të jem i/e suksesshëm në punën që do ta ushtrojë në të ardhmen.	43
Figure 13. Mësimdhënësi më motivon dhe lehtëson në zgjedhjen e drejtimit për të studiuar.	44
Figure 14. Sa më ndihmon qendra për orientim në karrierë në zgjedhjen e profesionit.	45
Figure 15. Sa ju ka ndihmuar moduli në zgjedhjen e drejtimit për ta studiuar apo profesionit për ta ushtruar në të ardhmen.	46
Figure 16. Sa keni arritur të njihni përparësitë dhe aftësitë tuaja për orientim në karrierë me ndihmën e mësimdhënësit.	47
Figure 17. Orientimi dhe këshillimi për karrierë shërben si një urë lidhëse ndërmjet shkollës dhe botës së punës.	48
Figure 18. A mendoni që nxënësit që marrin informatat të mjaftueshme nga mësimdhënësit për orientim në karrierë, janë më të suksesshëm në përzgjedhjen e profesioneve.	49
Figure 19. Mësimdhënësi me njohuritë dhe përvojën e tij në orientim në karrierë më këshillon drejtë në zgjedhjen e profesionit.	50
Figure 20. Zgjedhja e gabuar e profesionit më dërgon drejtë zhgënjimit dhe stresit në të ardhmen?.....	51

LISTA E SHKURTESAVE

MASHT Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë

DKA Drejtoria Komunale e Arsimit

KKK Korniza Kurrikulare e Kosovës

KB Kurikula Bërthamë

OJQ Organizatat jo Qeveritare

BE Bashkimi Evropian

Falënderim

Ky punim është një rrugëtim plot me përkushtim, punë dhe sakrificë deri në detajet më të vogla. Falënderimin do ta filloj me familjen time e cila vazhdimisht më ka përkrahur dhe më ka frymëzuar për të vazhduar tutje. Një falënderim i veçantë shkon për mentorin time Prof. Sylejman Berisha, i cili dha kontribut të madh me sugjerime të vazhdueshme duke ndihmuar këtë punim të dalë siç është më së miri.

KAPITULLI I

HYRJE

Në jetën bashkëkohore, çdo ditë ballafaqohemi me rëndësinë e zgjedhjeve para të cilave gjendemi. Zgjedhjet e tona, janë vendimet tona, që mund të ndikojnë tërë jetën, të cilat drejtojnë, ndërtojnë dhe zhvillojnë jetën. Sfida më të mëdha janë zgjedhjet dhe vendimet që me vete sjellin ndryshime të mëdha.

Me këtë studim motivimi i nxënësve për orientim në karrierë nga mësuesit, jemi fokusuar pikë së pari në informimin dhe zhvillimin e aftësisë së rinjve për zgjedhjen e profesionit.

Qëllimi kryesor i studimit është zhvillimi i aftësive të rinjve që të marrin dhe zbatojnë vendime të paramenduara, të vlefshme dhe të pavarura lidhur me zgjedhjen e shkollimit, profesionit, si dhe të planifikojnë karrierën dhe të kyçen në botën e punës. Mësimi për të rinjtë në kuadër të programit mësimor zhvillohet në forma të ndryshme, të cilat u mundësojnë atyre që përmes pjesëmarrjes aktive të fitojnë njohuri, aftësi, shkathtësi dhe vlera të nevojshme për realizimin e atij qëllimi.

Për orientim në karrierë rol të madh kanë edhe mësuesit, përmes praktikave të mësimdhënies, përmes ofrimit të përmbajtjeve mësimore që kanë qëllim informimin dhe orientimin profesional, si dhe përmes organizimit të aktiviteteve të lira dhe aktiviteteve jashtë kurrikulare me nxënës duke i informuar për rëndësinë e orientimit dhe këshillimit për karrierën.

Ky proces fillon që në fëmijërinë e hershme në familje dhe institucione parashkollore, për të vazhduar pastaj në institucione shkollore, ku rolë të madh luajnë mësuesit duke informuar nxënësit, me synim ofrimin e mundësive për të rinjtë që të zhvillojnë personalitetin, të përgatitën për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe të marrin orientim të drejtë për profesion. Rol me rëndësi në edukim dhe orientim për karrierë ka nxjerrja e broshurave.

1.1 Rëndësia e orientimi për karrierë

Të rinjtë në moshën adoleshente ndodhen në një periudhë kur janë në udhëkryqet e jetës dhe para ndryshimeve të shumta. Intensiteti dhe domosdoshmëria e zgjedhjes dhe ndryshimet që në atë kohë nuk përsëritet në asnjë periudhë tjetër të jetës. Kjo është periudha kur përmes vendimeve dhe ndryshimeve mësohet shumë dhe për atë është e domosdoshme që të krijohen kushte që individi i ri të bëhet i fortë dhe të sjellë vendimet më të mira për vetvetën dhe jetën e tij. Zgjedhja e profesionit është njëra ndër vendimet më të rëndësishme në jetë, e cila ndikon edhe në cilësinë e mëtejshme të jetës dhe punës (GIZ-2013).

Orientimi i drejtë i të rinjve për karrierë është në të mirë të të gjithë shoqërisë. Procesi i vendimmarrjes për karrierë është një nga vendimet më të rëndësishme, që kryesisht bëhet në adoleshencë. Studime të shumta raportojnë influenca të ndryshme të faktorëve të ndryshëm mbi zhvillimin dhe zgjedhjen e karrierës. (Liridona JEMINI – GASHI, 2013).

Studimet tregojnë se të rinjtë me vetefikasitet të lartë, me pritshmëri dhe qëllime për karrierën, janë më të prirur të bëjnë zgjedhje të sigurt të karrierës, faktorë që fuqizohen nga ana e Teorisë Social- Konjitive mbi Karrierën. Teoria e John Holland zë një vend të posaçëm, sipas tij të rinjtë zgjedhin atë karrierë që është në përputhje me tiparet e personalitetit, përndryshe, Holland thekson se të rinjtë që nuk kanë përputhje midis tipareve të personalitetit dhe mjedisit të punës, vazhdimisht do të tentojnë të ndryshojnë karrierën deri të ndihen mirë me zgjedhjen e bërë.

Përveç faktorëve personalë, në vendimmarrjen e adoleshentëve për karrierë ndikim të madh ushtron edhe përkrahja e prindërve, shkollës/mësimdhënësve dhe e bashkëmoshatarëve, si dhe faktorë të tjerë të kontekstit më të gjerë. Sipas Ferry, të rinjtë që kanë raportuar përkrahje nga prindërit, mësimdhënësit, bashkëmoshatarët dhe faktorët e tjerë kontekstualë kanë vendosur më herët për karrierën e tyre, si dhe kanë qenë më të sigurt për vendimin e marrë.

1.2 Qëllimi i motivimit dhe orientimit për karrierë

Qëllimi i orientimit për karrierën në shkolla është të ndihmojë të rinjtë të marrin vendime realiste dhe të mirë-informuara për karrierën e tyre. Me qëllim për t'i ndihmuar ata për ta bërë një gjë të tillë. Ata duhet të kalojnë përmes një procesi me anë të të cilit janë duke përshtatur interesat dhe aftësitë e tyre me mundësitë që janë të disponueshme për ta. Ata duhet të hulumtojnë vetë idetë e tyre dhe të zbulojnë nëse mundësitë janë realiste, nuk të mbështeten vetëm në opinionet e të tjerëve.

Çdo i ri/e re është një individ me shpresa dhe aspirata për të ardhmen. Ndonjëherë aspiratat e tyre mund të jenë të paarrtshme, por është e rëndësishme të mbahet mend se në shkollat tona të sotme janë politikanët, aktorët dhe sportistët e së nesërme! Intervistat e orientimit për karrierën janë produktet e këshilluesve të karrierës. Sesionet përdorën për të ndihmuar të rinjtë për të planifikuar dhe implementuar një plan veprimi për karrierën e tyre.

Intervista për orientimit në karrierë ju ofrojë mundësinë të rinjëve që të flasin për një situatë apo problem që lidhet me planifikimin e karrierës së tyre me një këshillues në një mënyrë ndihmuese dhe të strukturuar me qëllim që ata, të mund të bëjnë një zgjidhjen reale të situatës me të cilën përballen, dhe të mund të zgjedhin veprimin e duhur të mund të zhvillojnë kapacitetet e tyre me qëllim për t'u përballur me situata dhe probleme në të ardhmen. Qasja e intervistuesit nuk duhet të jetë paragjyquese, kritike ose vlerësuese. Ajo duhet të jetë totalisht e paanshme.

Qëllimi është thjeshtë të orientojmë individin për të marrë vendime realiste dhe të mirë-informuara bazuar në situatën dhe aspiratat që kanë për karrierën e tyre. Intervistat e orientimit për karrierën ndryshojnë nga tipet e tjera të intervistave. Në këto lloj intervistash këshilluesi bënë një intervistë që është e orientuar ndaj nxënësit i intervistuari inkurajohet të flasë për situatën ose çështjen e karrierës së tij dhe intervistuesi dëgjon me kujdes dhe e ndihmon atë për t'u qartësuar si dhe i jep prioritet ndjenjat e tij/saj me qëllim për të marrë një vendim (Arulmani.G, 2011).

Në këtë mënyrë, përgjegjësia individuale për problemet rritet. Varësia dhe tendenca për të fajësuar të tjerët pakësohen. Dhënia e këshillave dhe informacionit ose përdorimi i autoritetit mund të jenë të përshtatshme në një situatë tjetër por jo gjatë orientimit. Me qëllim për të kuptuar më qartë se si është një intervistë ose qasje e orientimit për karrierën, është e rëndësishme që të mbahet mend, se intervistuesi duhet të jetë i paanshëm dhe jo paragjyqes

me qëllim që të ndihmojë nxënësin për të marrë në konsideratë alternativa dhe ide për veten e tij. Këshilluesi profesionist i karrierës nuk do të japë një zgjidhje por do të punojë me individin të marrë mbi vete përgjegjësinë për të identifikuar zgjidhje të mundshme. Përvoja ka treguar se nëse përpiqeni të jepni një zgjidhje prej eksperti do të përballeni me rezistencë nga ana e të intervistuarit. Intervistuesi do ta drejtojë individin përmes një procesi, i cili do ta bëjë at të aftë për të marrë një vendim realist për karrierën bazuar në analiza të interesave dhe aftësive të tyre dhe mundësive që i ofrohen. Intervistuesi do t'i kërkojë atij të hulumtojë situatën e tij aktuale dhe atë çfarë ai dëshiron të bëjë në të ardhmen, duke e ndihmuar atë të marrë vendimin realist, i cili do të kthehet në një plan veprimi për karrierën, me qëllime dhe objektiva të përcaktuara dhe duke e ndihmuar atë të vendosë rreth mënyrës të arritjes së qëllimit (Schater, 1999).

Shumica e psikologëve (Erikson, 1959) e konsiderojnë adoleshencën si një periudhë përcaktuese të vet ndërtimit. Është koha që adoleshentët zhvillojnë shumë "veten" dhe janë veçanërisht të ndjeshëm ndaj ideve që kanë të bëjnë jo vetëm me të ardhmen e shoqërisë, por edhe me atë që ata ëndërrojnë për t'u bërë. Për të parafrazuar (Ginzberg, 1951) adoleshencia është koha e zgjedhjes paraprake, në të njëjtën kohë, kjo periudhë është ajo e kërkimit të qëndrueshmërisë personale të bazuar vlera të caktuara ose projekte personale. Prandaj, në këtë kohë, presionet familjare, sociale dhe akademike ndikojnë në mënyrë eksplicite ose implicite të adoleshentët për të identifikuar qëllime të caktuara në vend të të tjerëve (Guichard, 2011).

1.3 Procesi i orientimit për karrierë

Ku jam unë tani?

Këshilluesi i orientimit do të vëzhgojë situatën aktuale dhe do të hulumtojë në lidhje me nxënësin mbi:

- Eksperiencën,
- Aftësitë dhe Interesat,
- Kualifikimet,
- Çfarë pritet nga puna,
- Vlerat, sjellja dhe personaliteti dhe
- Pengesat dhe faktorët kufizues.

Vetë-vlerësimi - Intervistat e karrierës për hulumtimin dhe të kuptuarit e vetës. Aktivitete në grup ku dua të jem? Këshilluesi do të zbulojë njohuritë aktuale të nxënësit në

lidhje me botën e punës dhe do t'a ndihmojë atë të zhvillojë aftësi për të mbushur boshllëqet në botëkuptimin e tij. Ata do të diskutojnë për: (College, 2015).

- Njohuritë e tyre mbi tregun e punës,
- Mundësitë e punësimit,
- Mundësitë për trajnime,
- Mundësitë për shkollim të mëtejshëm dhe
- Kurse kualifikimi afat-shkurtër/afat-gjatë.

Njohja e mundësive - Aktivitete në grup për të hulumtuar mundësitë. Intervista karriere për të kontrolluar të kuptuarit dhe për ta lidhur këtë me vetë-vlerësimin. Këshilluesi do të punojë me nxënësin për ti ndihmuar atë në marrjen e vendimeve realiste duke: (College, 2015).

- Përshtatur vetëvlerësimin me mundësitë,
- Hartuar një plan veprimi,
- Vlerësuar informacionin dhe
- Tejkualuar pengesat.

Marrja e vendimit - Intervistat e orientimit për të identifikuar nëse vendimet janë realiste. Aktivitete në grup për të zhvilluar teknikat e marrjes së vendimeve. Si do të arrij unë atje? Këshilluesi do të përfundojë procesin duke ndihmuar nxënësin për të punuar planin e veprimit me qëllim për të arritur objektivat. Ai do ta ndihmojë atë të përmirësojë të kuptuarit në lidhje me: (College, 2015).

- Tregun e punës dhe procedurat e aplikimit,
- Mundësitë e punësimit dhe programet e trajnimit duke e ndihmuar atë për të identifikuar mënyrat e mundshme të hyrjes.
- Si të shkruajë një CV apo si të plotësojë një aplikim,
- Si të shkruajë një plan veprimi duke përcaktuar dhe duke punuar për synime dhe objektiva të arritshme.

Plani i veprimit - Intervistë orientimi për të plotësuar dhe kontrolluar planin e veprimit. Aktivitete në grup për të implementuar planin e veprimit (College, 2015).

1.4 Teoria e Donald Super-it mbi hapësirën jetësore të zhvillimit të karrierës

Vendimmarrja për zgjedhjen e profesionit e karrierës shqyrtohet në shumë teori. Pikëpamja teorike dominuese në studimet për zhvillimin e planeve profesionale ka qenë ajo e Donald Super, sipas tij, eksplorimi dhe kristalizimi i zgjedhjes së karrierës është një detyrë e rëndësishme zhvillimore për adoleshentët.

Zgjedhja e karrierës është parë si një proces i vazhdueshëm përgjatë gjithë jetës. Në faza të ndryshme të jetës, detyra të ndryshme zhvillimore duhet të realizohen në mënyrë që të arrihet pjekuria për karrierën. Dy parimet kryesore të teorisë së Super-it janë se zhvillimi i karrierës është i përhershëm dhe se vetë koncepti është formuar si çdo fazë e jetës dhe që ushtron ndikimin e vet në sjelljen e njeriut.

Një nga kontributet më të mëdha të Donald Super për zhvillimin e karrierës ka qenë theksimi mbi rëndësinë e zhvillimit të vetëkonceptit. Sipas Super, vetë koncepti ndryshon me kalimin e kohës dhe zhvillohet si rezultat i përvojës dhe në këtë kuptim, zhvillimi i karrierës bëhet gjatë gjithë jetës. Njerëzit zgjedhin profesione që u lejojnë të shprehin konceptet për veten e tyre. Modelet e karrierës janë të përcaktuara nga faktorë socialekonomikë, aftësitë fizike e mendore, karakteristikat personale dhe nga mundësitë ndaj të cilave personat janë ekspozuar. Njerëzit kërkojnë kënaqësinë e karrierës nëpërmjet roleve të punës në të cilën ata mund të shprehin veten dhe ku zbatojnë e zhvillojnë vetë konceptet.

Pjekuria e karrierës, një koncept kryesor në teorinë e Super, është manifestuar në realizimin me sukses të detyrave të moshës e fazave të zhvillimit në të gjithë jetën.

Sipas Super, fazat e zhvillimit profesional janë:

- rritja (4-13 vjeç),
- eksplorimi (14-24 vjeç),
- krijimi (25-44 vjeç),
- mirëmbajtja (45-65 vjeç) dhe
- rënia (mbi 65 vjeç).

Përgjatë moshës 4-13 vjeç, fëmijët janë në fazën e rritjes, ndaj zhvillojnë një sens mbi botën e punës dhe fillojnë të formojnë konceptin për veten se kushë janë dhe si ndryshojnë nga të tjerët. Fëmijët fillojnë të formojnë shkathtësi bazike, të cilat i pajisin me njohuri rreth punës në një komunitet më të gjerë. Ata gjithashtu rrisin besimin mbi aftësitë e tyre për të bërë mirë detyrat që u parashtrihen, si dhe për të marrë vendime mbi veten e tyre. Gjatë kësaj periudhe, pritet që fëmijët gjithashtu të zhvillojnë aftësitë e tyre sociale dhe të balancojnë një

bashkëpunim të tillë social me një qëndrim konkurrues, që synon arritjen e një pike optimale të funksionimit. Nga fundi i fazës së rritjes, fëmijët bëhen më të vetëdijshëm dhe më të shqetësuar lidhur me të ardhmen e tyre në një afat më të gjatë kohor.

Ka katër detyra të mëdha të karrierës zhvillimore që zbatohen në fazën e rritjes:

- shqetësimi për të ardhmen;
- rritja e kontrollit personal mbi jetën e vet;
- bindja e vetes për arritje në shkollë dhe punë;
- përmisim i shprehive dhe qëndrimeve për punë.

Nga mosha 14 deri 24 vjeç, adoleshentët rrisin të kuptuarit për veten e tyre, përkatësisht arrijnë të kuptojnë më mirë aftësitë e tyre. Ata gjithashtu fillojnë të eksplorojnë botën e punës në mënyrë që të bëjnë një zgjedhje fillestare, që do të rezultojnë në zbatimin e një zgjedhjeje të karrierës. Specifikimi i një zgjidhjeje profesionale kërkon që individi të eksplorojë thellësisht midis preferencave për t'u përgatitur dhe deklaruar për zgjedhje profesionale. Zbatimi apo implementimi kërkojnë që individi të bëjë zgjedhjen duke i konvertuar idetë në veprime që e bëjnë fakt. Zbatimi dhe aktualizimi i zgjedhjes profesionale përfshin përfundimin e trajnimit / edukimit të nevojshëm dhe përjetimin e punës për profesionin e caktuar. Faza e krijimit (25-44 vjeç) përfshin zbatimin e vetëkonceptit në një rol profesional.

Si çdo fazë tjetër, edhe kjo fazë parasheh realizimin e disa detyrave të zhvillimit profesional. Në radhë të parë është stabilizimi, që konsiston në bërjen e sigurt të pozitës, duke asimiluar kulturën organizative dhe kryerjen e detyrave të punës në nivel të kënaqshëm. Detyra tjetër e fazës së krijimit është konsolidimi, që përfshin demonstrimin e qëndrimeve dhe shprehive pozitive të punës, si dhe kultivimin e marrëdhënieve të mira me bashkëpunëtorët. Detyra e tretë e individëve që gjenden në fazën e krijimit është avancimi në nivelet më të larta të përgjegjësisë.

Individët në fazën e mirëmbajtjes (mosha 45 – 65 vjeç), janë të përgatitur për profesionin që ushtrojnë. Ata janë relativisht të kënaqur me punën e tyre dhe kryesisht janë të gatshëm të bëjnë ndryshime radikale në rast të ndonjë krize. Individët në këtë fazë punojnë drejt stabilitetit të karrierës së përhershme dhe në mirëmbajtjen e mbrojtjen e aftësive të fituara.

Individët gjatë kësaj faze duhet të përmbushin detyrat, si:

- mbajtjen e ruajtjen e asaj që kanë arritur deri në këtë fazë,
- përparimin e vazhdueshëm të shkathtësive dhe njohurive,
- sjellje të risive duke bërë detyra të ndryshme dhe
- duke zbuluar sfida çdo herë e më të reja.

Faza e fundit e zhvillimit profesional, sipas Super, është rënia apo dalja në pension, që përfshin moshën mbi 65 vjeç. Kjo fazë shihet si një tranzicion i madh i karrierës. Është një fazë e mosangazhimit, ku individët duhet të ndahen nga profesioni i tyre dhe të planifikojnë e organizojnë një stil të ri të jetesës.

Donald Super dhe teoricienët e tjerë të zhvillimit të karrierës marrin në konsideratë ndryshimet që njerëzit kalojnë gjatë pjekurisë së tyre. Pjekuria e karrierës nënkupton gatishmërinë për t'u përballur me detyrat e zhvillimit në një fazë të caktuar. Pra, Super e shtrin teorinë e tij, duke zhvilluar pjekurinë për karrierë.

KAPITULLI II

SHQYRTIMI I LITERATURËS

Një ndër temat e rëndësishme e të rinjëve (nxënësit, studentët), është orientimi në karrierë dhe motivimi, që paraqitet gjatë rrugëtimit jetësor, me përfundimin e shkollimit fillorë, të mesëm apo studimeve, ku të rinjët janë në një fazë që duhet të vendosin për zgjedhjen e drejtimit apo profesionit.

Faktorët që influencojnë vendimarrjen e adoloshentëve kosovarë për zgjedhje të profesionit, studimi ka për qëllim të analizojë procesin e vendimmarrjes së adoleshentëve kosovarë për karrierë dhe faktorët me influencë mbi këtë proces. Punim i gradës shkencore “Doktor” nga MA. Liridona JEMINI – GASHI, Tiranë, 2014.

Motivimi dhe performanca në punë, qëllimi kryesor i studimit ishte të përshkruajë dhe të identifikojë nivelin e përgjithshëm të motivimit, faktorëve motivues si dhe ndikimin e tyre në performancën e mësimdhënies të mësuesit e arsimit bazë dhe atij parauniversitar. Punim i gradës shkencore “Doktor” nga M.Sc. Ortenca KOTHERJA, Tiranë, 2015.

Ndikimi i TIK-ut tek nxënësit në orientimin dhe këshillimin për karrierë, qëllim i këtij studimi ishte të orientojë nxënësit në profesionet e ardhshme të tyre duke përdorur TIK-un..

Ndikimi i TIK-ut tek nxënësit në orientim dhe këshillim për karrierën është prioritet i MASHT-it për të hartuar strategji këshilluese dhe orientuese për të shtuar përmbajtje programore në fushën jeta dhe puna për orientim dhe këshillim për karrierën. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Prishtinë, 2011.

Korniza e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës. Përmbajtjet programore të jenë sa më të kjarta, që të jenë praktike për nxënësit dhe të motivohen mësimdhënësit në rolin e tyre si këshillues për profesionet e nxënëve, të kenë adresa elektronike ku nxënësit të informohen me profesionet dhe mundësitë që ofrohen për studim dhe punësim. Mësimdhënësit e TIK-ut të orientoohen në modulet adekuate për demonstrimin e përmbajtjeve programore. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, 2012.

Masht dhe Giz, hartuan strategji për përfshirjen e mësimdhënësve të TIK-ut në trajnime për të realizuar me sukses orientimin dhe këshillimin për karrierë për nxënësit e klasëve të X-ta, me mundësi vazhdimi edhe për klasët XI dhe XII. Qëllimi i moduleve me përmbajtje këshilluese për karrierën në fushës Jeta dhe Puna është i rëndësishëm për nxënësit dhe

shoqërinë. MASHT dhe Giz, (2010). Köhler, H & Burghard, J (pa datë). “Draftstrategjia dhe plan veprimi për orientimin dhe këshillimin në karrierë 2013- 2016. MASHT.

Ministria hartojë plan strategjik për klasën e X-ta, një modul për orientim dhe këshillim për karrierë, modul ky i parapare të ligjërohet nga mësimdhënësit e TIK-ut në Fushën Jeta dhe Puna. Rekomandimet për planët e hartuara nga MASHT-i, të ketë udhëzime metodologjike për implementimin në praktikë, në punë me nxënës. MASHT, (2011). Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2011 – 2016.

GIZ, materiale, broshura me koncepte dhe përkufizime për orjentim dhe këshillim për karrierë. Giz. (2011). Orientimi për karrierën: koncepte dhe përkufizime.

2.1 Motivimi dhe vendimarrja për orientim në karrierë

Mësuesi është subjekti që i jep institucionit besueshmëri. Ai luan një rol themelor në formimin e kapitalit njerëzor. Çdo aspekt që ndikon në rritjen e motivimit dhe kënaqësisë së tyre në punë duhet të shihet si i rëndësishëm. Ai është aktori kryesor që duhet të zhvillojë mësimdhënien, me synim zotërimin e kompetencave themelore në bazë të standardeve të të nxënësve, duke përzgjedhur ndërmjet metodave bashkëkohore më të mira, vendase dhe të huaja Fletore zyrtare (2012).

Motivimi përfaqësohet nga forcat që veprojnë tek një personi dhe që e detyrojnë atë të sillet në një mënyrë të caktuar, të orientuar nga disa qëllime. Do të studiohet motivimi në secilin prej akterëve të sistemit arsimor: mësues, nxënës ku mësuesi luan rol kyç në motivimin e nxënësve për një proces të suksesshëm të mësimnxënies.

Fullan shprehet, se reformë në arsim do të thotë të ndryshosh kulturën e klasave, shkollave, rretheve, universiteteve (Fullan, 2010). Shkolla duhet të shihet si një institucion kyç dhe thelbësor që i shërben shoqërisë për edukimin dhe zhvillimin e njohurive, duke e bërë individin të aftë të përballë me realitetin e së tashmes dhe e parapërgatit për të ardhmen. Ky është një kusht paraprak i domosdoshëm për një shoqëri dinamike, demokratike, socializuese, ku anëtarët e saj njihen me vlera të caktuara qytetare që drejtojnë dhe përfaqësojnë sektorë të ndryshëm të shoqërisë sonë.

Ndryshime të dukshme janë bërë në infrastrukturën moderne të institucioneve shkollore dhe në ligjet arsimore, por thelbësore duhet të mbetet puna e mësuesit, pasi përcakton

dukshëm shkallën e suksesit apo të dështimit në përpjekjen e institucionit për të kontribuar drejt arritjeve dhe qëllimeve kombëtare në zhvillimin e arsimit (Seniwoliba, 2013). Sipas tij mësuesi është njëkohësisht një mishërim i kapitalit njerëzor dhe një kanal në të cilin burimet njerëzore të një kombi janë zhvilluar, prandaj kënaqësia dhe plotësimi i nevojave, bazuar në motivimin e tyre, duhet të kenë një rëndësi të madhe. Ata luajnë një rol thelbësor në jetën e mësuesit, sepse formojnë themele të rëndësishme në punën e tyre.

Një element i rëndësishëm dhe shumë frytdhënës që ndihmon mësuesit në punën e tyre, është motivimi. Synimi i këtij fenomeni është të rrisë produktivitetin e procesit mësimor në institucionin shkollor. Në çdo ambient pune është shumë e rëndësishme që drejtuesit dhe menaxherët të jenë vigjilentë, nëse duan të kuptojnë lëkundjet e produktivitetit ose arritjet e institucionit në tërësi. Nëse në një institucion shkollor vërehet se ka rënie të punës, atëherë duhet parë në radhë të parë se sa motivues është ambienti ku ata punojnë e më pas të shihet performanca e tyre në ambientin e punës. Për të pasur produktivitet në çdo ambient pune është mjaft i rëndësishëm motivimi dhe faktorët nxitës të tij që përbëjnë një shtysë, e cila ndikon në arritjen me sukses të shërbimeve që ofrohen nga stafi pedagogjik në tërësi.

Performanca dhe produktiviteti i tyre në punë duhet të shihet si një shqetësim serioz në shoqëri, pasi kjo lidhet drejtpërdrejt me njohuritë dhe aftësitë e nxënësit, përdorimin e metodave të mësimdhënies, kënaqësinë që ata shfaqin për punën, etj.

2.2 Faktorët motivues të jashtëm dhe të brendshëm

Motivimin ne e shohim si një forcë nxitëse, kur e trajtojmë në tërësi, por nëse hulumtojmë me detaje, shohim se kjo forcë nxitëse realizohet nga faktorë të brendshëm ose të jashtëm, të cilët arrijnë ta nxisin këtë fenomen, ku individit arrin të plotësojë qëllimet e veta personale dhe të institucionit/organizatës në tërësi. Studiuesit Brehm dhe Self, në lidhje me faktorët motivues kanë argumentuar rëndësinë që ata kanë në madhësinë dhe intensitetin e motivacionit. Sipas tyre, faktorët e brendshëm ose të jashtëm ndikojnë në rritjen e nivelit të kënaqësisë, duke ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e nivelit të motivimit (Brehm & Self, 1989). Motivimi është përkufizuar si proces që përbëhet nga drejtimi, intensiteti dhe këmbëngulja e individit për të arritur një qëllim. Në këtë linjë, lindë pyetja: “Çfarë e motivon një individ?” Studiues dhe hulumtues të ndryshëm kanë identifikuar dy lloje të motivimit:

- **Motivimi i brendshëm** i referohet një dëshire të brendshme për të bërë diçka, pra, interes, sfidë dhe kënaqësi personale.

- **Motivimi i jashtëm** lidhet me faktorët e jashtëm, si paga, bonuset dhe lloje të tjera shpërblimesh të prekshme (Ran, 2013).

Në lidhje me motivimin e brendshëm, (Ryan & Deci, 2000) kanë argumentuar se motivimi shihet si një konstrukt i rëndësishëm, pasi ai pasqyron prirjet e njeriut për të mësuar dhe asimiluar, si dhe konceptohet si diçka e natyrshme. Ai ndikon në cilësinë e lartë të kreativitetit dhe të të mësuarit, si dhe është përcaktuar si një aktivitet i bazuar në kënaqësi, që ekziston brenda individëve, në marrëdhëniet midis tyre dhe aktiviteteve, ku individi është i motivuar së brendshmi për disa aktivitete po e për disa jo, (Ryan & Deci, 2000). Në këtë drejtim duhet theksuar se, edhe pse motivimi i brendshëm është i rëndësishëm, njerëzit shpesh kryejnë detyra e veprimtari të ndikuar dhe nga faktorë të jashtëm. Në procesin edukues studiuesit e kanë parë motivimin e brendshëm dhe të jashtëm bazuar në tre tipa që ndikojnë në fuqinë në tërësi të motivimit. Tri llojet e motivimit të brendshëm janë: të dish, i cili përkufizohet si një fakt për të performuar një aktivitet bazuar në kënaqësi të brendshme që individi merr gjatë të mësuarit dhe të eksploruarit. Motivimi i brendshëm bazuar në arritje, i cili ka të bëjë me realizimin e një veprimi bazuar në kënaqësi dhe në një eksperiencë të kënaqshme, ku individi përpiqet për të kryer apo për të krijuar diçka. Dhe lloji i tretë, i cili bazohet në kënaqësinë që është operative, kur dikush angazhohet në një aktivitet, në mënyrë që të përjetojë ndjenjat e stimuluar që kalojnë nga angazhimi në aktivitet.

Motivimi i jashtëm ka tri elemente bazë:

Rregullatori i jashtëm - bazohet në shpërblime dhe kufizime, ku individi arrin të kryejë një veprimtari të caktuar, por gjatë rrugës ai përballlet me kufizime, p.sh. në ambientin e punës një mësues mund të kufizohet në kryerjen e detyrës nga mungesa e mjeteve materiale.

Introjeksioni - ku individi e përgjithëson veprimin që ai/ajo kryen që nënkupton faktin, p. sh. një mësues e kryen një veprimtari, pasi kolegu/kolegia i tij/e saj e ka kryer këtë veprimtari.

Identifikimi - kur dikush e kryen një veprim se e sheh të rëndësishëm për veten e tij, p.sh. një mësues e kryen një veprim se e sheh të nevojshëm në punën e tij/saj (Vallerand, Pelletier, Blais, Briere dhe Vallieres, 1992). Nisur nga trajtimet e mësipërme shohim se motivimi si një forcë e brendshme nxitëse bazohet në dëshirën, kënaqësinë personale të gjithësecilit nga ne, ndërsa motivimi i jashtëm bazohet në faktorët e jashtëm, ku shpeshherë mospërmbushja e tyre ndikon dhe në uljen e kënaqësisë së brendshme të individit. Nëse kemi ulje të motivimit të jashtëm apo edhe të brendshëm, do të shihet dukshëm ulja e performancës

në punën e gjithësecilit. Motivimi dhe ndjenja e kënaqësisë në institucione të ndryshme ka një rëndësi të dukshme, pasi kënaqësia në punë dhe motivimi janë të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin (Bush & Middlewood, 2013). E thënë ndryshe, stafi i punonjësve kërkon që të ndihen mirë dhe të kuptojnë se janë duke kryer një punë të mirë dhe kur kjo është e krijuar, eprori mund të ndërtojë mbi këtë motivimin e punonjësve për të ecur përpara, ndërsa kur ka baza pakënaqësie, ka shumë pak hapësirë për motivim. Motivimi në nivele të kënaqshme ndikon drejtpërdrejt edhe në produktivitetin apo e thënë ndryshe, në performancën e punonjësve. Kënaqësia e lidhur ngushtë me nivelin e motivimit të punonjësve është e rëndësishme, pasi ndikon në besnikërinë e punonjësve, efikasitetin në vendin e punës dhe cilësinë e jetës dhe të tëra së bashku ndikojnë në performancën e tyre në tërësi (Swathi, 2013). Puna në ditët e sotme është e ndryshme, e larmishme dhe vazhdimisht në ndryshim. Në institucionet shkollore niveli i faktorëve motivues të mësuesit është shumë i rëndësishëm, ai ndikon drejtpërdrejt në procesin mësimor në tërësi dhe në arritjet akademike të nxënësve.

Në sajë të studimeve të ndryshme janë vënë re katër faktorë kryesorë ndikues në motivimin e mësimit të mësuesit:

- faktori social, që nënkupton sjelljen dhe reagimin e anëtarëve të tjerë të institucionit në tërësi dhe të komunitetit;
- zëvendësuesi psikologjik, që nënkupton plotësimin e një nevojë, jo duke u bazuar te kërkesa aktuale e nevojës, por duke e plotësuar këtë nevojë me diçka tjetër;
- motivuesi bazë, që nënkupton plotësimin e nevojave bazë dhe
- perceptim i rezultateve (Castle dhe Buckler, 2013).

Siç shihet, kemi të bëjmë me dy grupe në motivimin e brendshëm dhe të jashtëm, që ndikojnë në procesin e mësimit të mësuesve. Studime të ndryshme kanë hulumtuar si motivimin e jashtëm, ashtu edhe atë brendshëm duke i trajtuar secilin më vete dhe duke i parë si faktorë parësorë në kryerjen e shumë aktiviteteve dhe veprimtarive. Shpesh janë bërë dhe diskutime ku studiues të ndryshëm kanë parë si parësor motivimin e brendshëm në kryerjen e veprimtarive jetësore dhe në rritjen e nivelit të performancës në punë. Gjithashtu, janë bërë studime të ndryshme ku këta faktorë (i jashtëm dhe i brendshëm) janë parë të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin. Me rëndësi është të theksohet fakti që shpesh shpërblimet dhe përfitimet (faktorë i jashtëm) mund të rrisin kënaqësinë e brendshme, por ka raste kur kjo kënaqësi na bën që të nxitemi nga stimuli i jashtëm, sado që ai mund të mos jetë tërheqës ose në përputhje me interesat tona.

2.3 Motivimi, faktorët motivues dhe performanca në punë

2.3.1 Paga, përfitimet në punë dhe performanca

Paralel me qëllimin e këtij studimi është edhe ai i studiuesve Ud Din, Tufail, Shereen, Nawaz, dhe Shahbaz. Studimi i tyre u bazua te intervistimi i 40 mësuesve të nivelit të mesëm dhe të lartë, ku nga rezultatet u vu re se peshën më të madhe në motivimin e tyre në procesin e mësidhënies si faktor primar në punën e tyre ishin paga dhe përfitimet duke e parë atë si pjesë të rëndësishme vlerësuese të statusit të tyre si mësimdhënës dhe më pas rëndësi i jepej statusit socio-ekonomik, statusit social (Ud Din, Tufail, Shereen, Nawaz dhe Shahbaz 2012). Por, nga një studim i kryer nga Shakir & Zamir mbi rëndësinë e pagës në performancën e punës të mësuesit e arsimit të mesëm të ulët, u vu re se mësuesit ishin të kënaqur me shpërblimet e jashtme, si paga, shpërblimet, ndihmat sociale duke mos e parë atë si faktor shqetësues për performancën e tyre në punë. Ata e vinin theksin në rëndësinë e shpërblimeve të brendshme të organizatës duke e lidhur këtë me nevojën për vlerësim, mirënjohje, njohje, etj, e cila bazohej kryesisht në aftësitë, kontributin e tyre për të cilin kërkonin një reagim nga drejtuesi i shkollës e cila kishte një rëndësi të madhe në motivimin dhe performancën e tyre në punë (Shakir dhe Zamir, 2013).

Në të njëjtën linjë qëndron dhe studimi i zhvilluar me 200 mësues të sistemit fillor në Nigeri në lidhje me rëndësinë e procesit motivues me efektivitetin e punës së mësuesit, në të cilin rezultoi paga si faktor i rëndësishëm motivues, por mënyra e pagesës për to sillte pakënaqësi dhe ulje në produktivitetin e tyre të punës. Kjo për vetë faktin pasi ata këkonin një pagë fikse, si dhe shpërblim të njëjtë të të gjithë punonjësit për punën që ata bënin (Adeyemi & Oyetade, 2011). Njëkohësisht paga duhet parë si faktor motivues i rëndësishëm, por shpesh mënyra e këtij motivimi duhet të jetë e kujdesshme.

Studiuesi Yamoah në studimin e tij të realizuar me mësuesit e shkollës së mesme në lidhje me pagën dhe natyrën e përfitimeve pohoi se paga, kryesisht paga fikse, kishte një marrëdhënie sinjifikante në lidhje me performancën, duke e konsideruar atë si të qenësishme dhe të dobishme. Edhe në këtë studim një rol të rëndësishëm në performancën e punës kishte edhe marrja e vendimeve të mësuesve mbi natyrën e shpërblimeve, ndihmës sociale, vlerësimin dhe mirënjohjen për punën e tyre (Yamoah, 2013).

2.3.2 Kushtet e punës dhe performanca në punë

Kushtet e punës luajnë një rol jetik në përmirësimin dhe efikasitetin e fuqisë punëtore ku përmirësimi i organizimit të punës është një nga mënyrat më të mira për të rritur produktivitetin (Swathi, 2013).

Gjithashtu, edhe përkushtimi i lartë në vendet e punës karakterizohet nga një angazhim i përbashkët midis punëdhënësve dhe të punësuarve duke krijuar një mjedis bazuar në komunikimin e hapur, punë sfiduese dhe shpërblyese, kushte të sigurta të punës, burime të mjaftueshme, përfitime të kënaqshme dhe një shkallë të lartë besimi.

Krijimi i kushteve të përshtatshme në shkollë sipas Kenneth ka një rëndësi të madhe në efikasitetin, kënaqësinë, angazhimin organizacional në moralin dhe stresin e individit në vendin e punës si dhe ka një influencë të madhe në performancën e mësuesve dhe njëkohësisht në procesin e mësimdhënies të nxënësit (Leithwood, 2006).

2.3.3 Orientimi drejt suksesit dhe performanca në punë

Orientimi drejt suksesit është një tjetër faktor motivues që ndikon në efikasitetin e punës së punonjësve. Të orientosh drejt suksesit nënkupton kënaqësinë që ndjen në këtë vend pune dhe dëshirën gjithmonë për të qenë produktiv në punë. Orientimi drejt suksesit nga ana e punonjësve në një institucion është shumë e rëndësishme. Kjo për vetë faktin se motivimi për punën do të jetë gjithmonë në rritje ku punonjësi do të punojë për të arritur sukses në punën e tij, e cila do të jetë e dukshme në performancën e punës së tij.

Studiuesi Ballout në studimin e tij pohon se sukcesi në punë dhe në karrierë të punonjësit ka një rëndësi të madhe për institucionin/organizatën. Sipas tij mjedisi i punës ndikon shumë në arritjen e qëllimeve duke përfshirë rritjen e kënaqësisë dhe angazhimin të punonjësve, e cila ka një efekt të drejtpërdrejtë në kënaqësinë e karrierës individuale dhe avancimit.

Që një punonjës të jetë i orientuar drejt suksesit duhet të ketë mbështetje organizative duke bërë që punonjësi të jetë në harmoni dhe me normat e grupit. Përshtatja e personit me mjedisin është një forcë dominuese në përzgjedhjen e punonjësve dhe në shpjegimin e kënaqësisë së punës së individëve dhe orientimit drejt suksesit në punë që ndikon edhe në performancën e punonjësve (Ballout, 2007).

Në lidhje me orientimin drejt suksesit dhe ndikimin në performancën e punës së punonjësve është mjaft e rëndësishme mënyra e shpërblimit të punonjësve. Mulhall e lidhi suksesin në karrierë me pagën që merrnin punonjësit kryesisht me ato me kohë të plotë. Por në studimin e tij ai pohoi se të gjithë punonjësit, si me kohë të plotë apo të pjesshme, paga ndikon në suksesin e tyre, e cila mund të ndikojë në ardhshëmrinë e personit duke i a lehtësuar atij pikëpamjet në lidhje me sistemin e tij ose të saj të vlerave (Mulhall, 2011).

Paralel me këtë linjë është edhe studimi i Cox dhe Harquail, në të cilin u arrit në përfundimin se në orientimin e drejtimit të suksesit të punonjësve ndërmjet femrave dhe meshkujve rëndësi të madhe kishte paga, marrëdhënia me kolegët, detyrat e punës dhe ndërmjet tyre u vu re një dallim në lidhje me orientimin e suksesit. Orientimi i punonjësve drejt suksesit në punë është një faktor i rëndësishëm që tregon se nëse një punonjës është i orientuar drejt suksesit nënkupton faktin se niveli i tij motivues në punë është në nivele të kënaqshme dhe kjo do të shfaqet dukshëm edhe në produktivitetin e tij në punë.

2.3.4 Bashkëpunimi me kolegët dhe performanca në punë

Bashkëpunimi në punë ndërmjet punonjësve ose drejtuesve është shumë i rëndësishëm në ambientin e punës. Ai u referohet punonjësve apo menaxherëve në zgjidhjen e çështjeve me interes të përbashkët duke u bazuar në diskutim dhe në konsultim nëse ekziston vullneti, dëshira dhe komunikimi i hapur ndërmjet kolegëve, i cili ndikon edhe në produktivitetin e tyre të punës (Heron & Vandenabeele, 1999). Të ndërtuarit e një marrëdhënieje pozitive dhe mbështetëse me kolegët në ambientin e punës, kërkon shumë punë dhe një përkushtim të jashtëzakonshëm nga të dy palët. Hulumtuesit pohojnë se çelësi i suksesit për një organizatë ose institucion është pikërisht krijimi i marrëdhënieve mbështetëse. Marrëdhëniet pozitive me kolegët ndikojnë drejtpërdrejt në motivimin e punonjësve, performancën e tyre, në kënaqësinë në punë dhe nivelin e stresit në ambientin e punës.

Sipas studiuesve Ramona dhe Allan në lidhje me rëndësinë e bashkëpunimit me kolegët në ambientin e mësuesve pohuan se në krijimin e një marrëdhënieje mbështetëse dhe fitimprurëse bazë në këtë marrëdhënie ishin transmetimi i pozitivitetit, konsiderimi i kolegëve dhe ambientit të punës si një familje, së treti krijimi i një raporti reciprok dhe së fundmi puna në progres, pra që të gjithë kolegët të investojnë në krijimin e një atmosfere pozitive që mund të ndihmojë punën dhe marrëdhënien mes kolegëve (Ramona, Viernes, dhe Allan , 2005).

KAPITULLI III

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Metodat e përdorura për t'u realizuar ky hulumtim janë:

- cilësore dhe
- sasiore.

Me anë të metodës sasiore janë realizuar dy pyetësorë për të nxjerrë rezultate të mjaftueshme nga tema e hulumtimit, rezultate të nxjerrura janë paraqitur në formë numerike dhe do të analizohen nga ana statistikore.

Me anë të metodave cilësore synohet të marrim mendime dhe bindje për temën e hulumtimit: Motivimi i nxënësve nga mësimdhënësit për orientim në karrierë në SH.F.M.U, Instrumentet e përdorura për realizimin e hulumtimit janë: Pyetësori i parë dhe i dytë. Në hulumtim janë përfshirë 100 nxënës të klasave të IX-ta të SH.F.M.U. “Ibrahim Rugova” në Podujevë. Fillimisht është realizuar një pyetësor për të shikuar gjendjen aktuale për orientimin dhe këshillimin për karrierë dhe rëndësia e mësimdhënësit për orientim në karrierë tek nxënësit. Pas përfundimit të modulit është realizuar pyetësori i dytë.

